



INFORMOHU PËR NDIHMËN JURIDIKE FALAS

www.pravnapomos.mk

ÇFARË ËSHTË NDIHMJA JURIDIKE FALAS?

E drejta e personave në një gjendje të vështirë financiare është të kenë qasje në ndihmë juridike dhe të lirohen nga pagesa e shpenzimeve për udhëheqjen e procedurave të caktuara.

SI MUND TË ARRIHET NDIHMA JURIDIKE FALAS?

Ndihma juridike falas mund të arrihet në dy forma.

NDIHMA JURIDIKE PRIMARE që përfshin informimin juridik, këshillimin, referimin dhe ndihmën në plotësimin e formularëve dhe parashtresave. Ndihma juridike primare është në dispozicion për të gjithë personat.

NDIHMA JURIDIKE DYTËSORE përfshin ndihmën për personat të cilëve udhëheqja e procedurës gjyqësore, administrative u është e domosdoshme dhe të cilët plotësojnë kushtet, dhe përfshin:

- ndihmë juridike nga një avokat për përfaqësim dhe përpilimin e një kërkesë me shkrim;
- lirim nga taksat gjyqësore dhe shpenzimet që lidhen me procedurat gjyqësore;
- lirim nga shpenzimet për ekspertizë;
- lirim nga taksat administrative;

CILAT JANË KUSHTET PËR ARRITJEN E TË DREJTËS SË NDIHMË JURIDIKE DYTËSORE

Një person ka të drejtë të marrë ndihmë juridike dytësore nëse, për shkak të gjendjes së tij financiare nuk mund t'i realizojë të drejtat e garantuara me Kushtetutë dhe ligj, pa rrezikuar jetesën tij dhe të anëtarëve të familjes.

KUSHTET NË RAPORT TË TË ARDHURAVE

- Të ardhurat mujore të kërkuesit i cili jeton vetëm nuk duhet të tejkalojnë shumën e neto pagës minimale në Republikën e Maqedonisë së Veriut, e përcaktuar me Ligjin për pagë minimale,
- Të ardhurat mujore të kërkuesit i cili jeton në një familje të përbashkët me anëtarët e familjes së tij nuk duhet të tejkalojnë shumën e neto pagës minimale dhe të ardhurat mujore të secilit anëtar pasues të familjes nuk e tejkalojnë shumën prej 20% të neto pagës minimale të përcaktuar me Ligjin për pagë minimale.

KUSHTET NË RAPORT ME PRONËN

- Personi dhe anëtarët e familjes së tij /saj të posedojnë në pronësi vetëm një objekt ose banesë të thjeshtë si pjesë të veçantë të ndërtesës në të cilën jetojnë;
- Përveç objektit / banesës në të cilën ata jetojnë, posedojnë një ose më shumë parcela kadastrale të lidhura fizikisht me një sipërfaqe totale që nuk i kalon 300 m² në Qytetin e Shkupit ose 500 m² në komunat e Republikës së Maqedonisë së Veriut, gjegjësisht një ose më shumë parcela kadastrale me një sipërfaqe totale jo më të madhe se 5000 m² në zonat rurale dhe
- Personi dhe anëtarët e familjes së tij të kenë vetëm një automjet të regjistruar, vëllimi i motorit i të cilit nuk i kalon 1,200 centimetra kub.

Si përjashtim, ndihma juridike dytësore mund të aprovohet pa përcaktuar dhe kontrolluar gjendjen e tyre financiare nëse:

- kërkuesi është vendosur në një familje akomoduese, njësi banesore për jetë të organizuar me një mbështetje ose në një ent për mbrojtje sociale;
- kërkuesi ka nevojë të iniciohet dhe përfaqësohet në një procedurë për shqiptimin e masave të përkohshme për mbrojtje nga dhuna në familje para gjykatës kompetente ose

- kërkuesi për shkak të një katastrofe natyrore, forcë madhore ose rrethanash të tjera që janë përtej kontrollit të tij e gjen veten në një gjendje financiare që e pengon atë të sigurojë në mënyrë të pavarur mbrojtjen e të drejtave të tij.

PËR CILAT ÇËSHTJE JURIDIKE MUND TË KËRKOJ NDIHMË JURIDIKE DYTËSORE?

Ndihma juridike dytësore aprovohet për përfaqësim në të gjitha nivelet në procedurat gjyqësore civile, procedurat administrative dhe kontestet administrative përveç: çështjeve doganore dhe tatimore; inicimit të procedurave për shpifje dhe fyerje; kompensimit të dëmit material, përveç në rastet e viktimave të veprës penale si dhe në rastet e vdekjes ose invaliditetit të rëndë; kundërvajtjet dhe procedurat e kundërvajtjes; shërbimet publike dhe komunale të përcaktuara në Ligjin për mbrojtjen e konsumatorëve dhe Ligjin për veprimtari komunale; çështjet e pronës në procedurën administrative (denacionalizim, privatizimi i tokës ndërtimore, legalizimi i ndërtesave të ndërtuara në mënyrë të paligjshme).

KU MUND TË DREJTOHEM PËR NDIHMË JURIDIKE FALAS?

Për informacion më të detajuar mbi kushtet dhe procedurën e realizimit të së drejtës për ndihmë juridike falas, mund të drejtoheni:

- Në njërën nga 34 zyrat rajonale të Ministrisë së Drejtësisë, sipas vendbanimit / qëndrimit tuaj:
https://www.pravda.gov.mk/Upload/Editor_Upload//kontakti_MP_PO_2019.pdf
- Shoqatat e qytetarëve të regjistruara për të siguruar ndihmë juridike falas:
<https://www.pravda.gov.mk/bpp>
- Klinikat juridike (në kuadër të fakulteteve juridike) të regjistruara për të siguruar ndihmë juridike falas:
<https://www.pravda.gov.mk/clinics>
- Avokatët me autorizime të arritura për të siguruar ndihmë juridike dytësore:
<https://www.pravda.gov.mk/bp-advokati>



Republika e Maqedonisë së Veriut
Ministria e Drejtësisë

Financuar
nga Bashkimi Evropian
dhe Këshilli i Evropës



COUNCIL OF EUROPE



Zbatohet
nga Këshilli i Evropës

